

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:

Pml Kzz 59/2015

(PKR Nr. 250/2013 Gjykata Themelore në Ferizaj)

(PN 1.163/2015 Gjykata e Apelit)

Data:

16 mars 2015

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja i EULEX-it Esma Erterzi (kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese), Gjyqtari i EULEX-it Willem Brouwer dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Valdete Daka si anëtarë të kolegjit, dhe Zyrtarja ligjore e EULEX-it Kerry Kirsten Moyes si procesmbajtëse, në lëndën penale me numër PKR Nr. 250/2013 pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, kundër;

B.S. [redacted] i lindur më [redacted] në [redacted] emri i babait [redacted] numri i personal i letërnjoftimit [redacted] me vendbanim në [redacted] shqiptar i Kosovës, me profesion [redacted] i arrestuar më 11 shtator 2013, në paraburgim prej 12 shtatorit 2013;

et al

I akuzuar për veprat penale në vazhdim:


Shpërdorim i pozitës zyrtare në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 339 (1) dhe (2) në lidhje me nenin 23 të ish Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), aktualisht e dënueshme sipas nenit 422 në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013;

Marrja e ryshfetit në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 343 (1) në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e dënueshme sipas nenit 428 në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013;

Ushtrim i ndikimit në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 345 (1) në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e dënueshme sipas nenit 431 (1) dhe nenit 31 të KPK-së të vitit 2013;

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 374 (1), në lidhje me nenin 120, pikën 38 të KPK-së të vitit 2013;

Duke vepruar lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës A.D. [redacted] më 11 shkurt 2015 në emër të pandehurit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR Nr. 250/13 të datës 22 janar 2015, mbi vazhdimin e paraburgimit për këtë të pandehur (dhe të një të bashkakuzuari) edhe për tre (3) muaj deri më 21 prill 2015, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN1. 163/15 të datës 31 janar 2015 për rritjen e ankesës së të pandehurit si të pabazuar;



Pas shqyrtimit të përgjigjes në kërkesë nga Prokurori i Shtetit KMLP.III. – ZZZK. III. Nr. 13/15 të paraqitur më 2 mars 2015;

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 16 mars 2015;

Sipas nenit 418 dhe neneve 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së)

lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur më 11 shkurt 2015 nga avokati mbrojtës A [REDAKTUAR], në emër të pandehurit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR Nr. 250/13 të datës 22 janar 2015, mbi vazhdimin e paraburgimit për këtë të pandehur (dhe të një të bashkakuzuari) edhe për tre (3) muaj deri më 21 prill 2015, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN1. 163/15 të datës 31 janar 2015, mbi refuzimin e ankesës së të pandehurit, refuzohet si e pabazuar.
2. Aktvendimet e kundërshtuara, vërtetohen.

ARSYETIM


I. Historia e procedurës

1. Më 23 mars 2013, Prokurori i EULEX-it ka lëshuar vendimin mbi fillimin e hetimit, i cili më pas më 28 mars 2013 është zgjeruar. Të pandehurit janë arrestuar më 11 shtator 2013, dhe më 12 shtator 2013, gjyqtari i procedurës paraprake ka caktuar paraburgimin prej një (1) muaji deri më 10 tetor 2013, ndaj të pandehurit (dhe të bashkakuzuarit). Ky aktvendim është ankimuar pa sukses dhe është vërtetuar nga Gjykata e Apelit.

2. Më 10 tetor 2013, gjyqtari i procedurës paraprake ka vazhduar paraburgimin për tre (3) muaj deri më 10 janar 2014. Ky aktvendim është ankimuar pa sukses.

3. Më 27 Dhjetor 2013, Prokurori ka ngritur aktakuzën PPS Nr. 5/12, me të cilën ka akuzuar të pandehurin (dhe të bashkakuzuarin) për veprat e lartpërmendura penale.

4. Rrethimisht, paraburgimi është vazhduar në disa raste, më së fundi më 22 janar 2015 ku masa është vazhduar për tre (3) muaj deri më 21 prill 2015. Më 28 janar 2015, avokati mbrojtës A [REDAKTUAR]



D [REDACTED] ka paraqitur ankesë kundër këtij aktvendimi, e cila më 31 janar 2015 është refuzuar si e pabazuar nga Gjykata e Apelit. Në ndërkohë, ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

5. Më 11 shkurt 2015, avokati mbrojtës A [REDACTED] D [REDACTED] ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër të dy aktvendimeve. Prokurori i Shtetit ka paraqitur përgjigjen më 2 mars 2015.

II. Parashtrësit e palëve

6. Avokati mbrojtës pretendon në shkelje të nenit 384 të KPP-së, dhe shkelje të dispozitave të të drejtave të njeriut sipas nenit 5 të të drejtave kushtetuese për liritë e njeriut. Ai propozon që masa e paraburgimit të ndërpritet dhe të zëvendësohet me masën e arrestit shtëpiak, ose lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për vendosje.

Avokati mbrojtës pohon:

- Se ka pasur shkelje të nenit 191 paragrafit 2 të KPP-së, i cili përcakton se,

'I pandehuri dhe mbrojtësi i tij informohen me propozimin jo më vonë se tri (3) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit'.

Ata nuk janë njoftuar me shkrim lidhur me kërkesën e prokurorit për vazhdimin e masës së paraburgimit dhe prandaj nuk kanë pasur mundësi që të përgjigjen me shkrim.

- Dispozitivi i aktvendimit (nuk e cek se cilit aktvendim i referohet) duhet patjetër të përmbajë cilësimin juridik të veprës penale si dhe përshkrimin e detajuar të të gjitha fakteve vendimtare të cilat janë bazë për vazhdimin e masës së paraburgimit.

- Nuk është e saktë, siç është theksuar nga Prokurori i PSRK-së, se tre dëshmitarët kryesorë të Prokurorisë kanë zbuluar sjelljen e kundërligjshme të të pandehurit.

- Neni 187 paragrafi 1, pika 1.2.2 nuk qëndron pasi që aktakuza është ngritur, dhe të gjitha provat janë mbledhur dhe janë duke u ekzaminuar gjatë procedurës penale në vazhdim e sipër. I pandehuri asnjëherë nuk ka bërë përpjekje që të shkatërroj, fshehtë apo ndryshojë ndonjë provë në lidhje me veprat penale për të cilat akuzohet.

- Të dy aktvendimet janë në shkelje të nenit 370 paragrafëve 6 dhe 7 pasi që nuk cekin se cilat fakte gjykata i konsideron si të vërtetuara apo të pavërtetuara.

- Nuk ekziston dyshimi i bazuar për veprat penale për të cilat akuzohet. Avokati mbrojtës ka vlerësuar provat të cilat ai pohon se janë paraqitur deri më tani gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe konstaton se nuk e arsyetojnë dyshimin e bazuar.

- Nuk ka asnjë provë materiale, dëshmi apo fakt për të provuar recidivizmin, siç kërkohej me nenin 187 paragrafin 1.2.3 të KPP-së. I pandehuri është larguar nga puna dhe tani nuk ka më qasje në stacionin e policisë.



7. Prokurorja e Shtetit propozon që kërkesa është e pabazuar dhe në disa pjesë e palejueshme.

Ajo pohon:

- Se nuk ka shkelej të nenit 191 paragrafit 2 të KPP-së. Më 16 janar 2015, avokati mbrojtës ka bërë parashtrësë për ndërprerjen e paraburgimit për shkak të përkeqësimit të shëndetit të të pandehurit. Prokurorit i është dhënë mundësia që të përgjigjet në atë propozim, mirëpo pasi që propozimi me shkrim i avokatit mbrojtës nuk i ishte dorëzuar Prokurorisë në atë kohë për shkak të mungesës së përkthimit në gjuhën angleze, Prokurorja ka rezervuar mundësinë që të përgjigjet ndaj propozimit me shkrim. Dokumenti i cili është dorëzuar më 21 janar 2015, në bazë të nenit 193 paragrafit 1 të KPP-së dhe të cilit i është referuar në aktvendimin e Gjykatës Themelore si një “mendim” apo “kërkesë”, nuk është pjesë e shkresave të lëndës. Përpjekjet e pasuksesshme të kryetarit të trupit gjykues që parashtrësën me shkrim të Prokurorit t’ia komunikojë avokati mbrojtës nuk janë shkelje e nenit 191 paragrafit 2 të KPP-së, sepse ajo dispozitë nuk është e zbatueshme në atë situatë. Ky dokument ka qenë përgjigje e Prokurorit ndaj propozimit të avokatit mbrojtës. KY nen është i zbatueshëm vetëm kur kërkesa është bërë nga Prokurori.

- Avokati mbrojtës nuk e mbështet pretendimin e tij se përshkrimi konkret i të gjitha fakteve vendimtare të veprës penale duhet të përfshihet në dispozitivet e aktvendimeve të kundërshtuara duke iu referuar autoritetit ligjor. Neni 370 paragrafët 6 dhe 7 të KPP-së përcaktojnë përmbajtjen dhe formën e aktgjykimeve me shkrim, dhe nuk zbatohen për aktvendimet mbi vazhdimin e paraburgimit gjatë gjykimin i cili është në vazhdim e sipër. Më tutje, përshkrimi i plotë i të gjitha fakteve në mbështetje të veprave penale është paraqitur në aktakuzë, e cila gjithashtu paraqet arsyet për dyshimin e bazuar.

- Në aktakuzë përshkruhet se si i pandehuri dhe i bashkakuzuari i janë afruar dëshmitarëve dhe palëve të dëmtuara në këtë lëndë. Akoma ka dëshmitarë të Prokurorisë që duhet të dëgjohen gjatë shqyrtimit gjyqësor. Për më tepër, rreziku i pengimit të procedurës penale nuk është arsyeja e vetme mbi të cilën është vazhduar paraburgimi.

- Rreziku i recidivizmit sipas nenit 187 paragrafit 1 nën-paragrafëve 1.2.3 të KPP-së nuk kërkon që të kryhet e njëjta veprë penale. As fakti se i pandehuri nuk është më Polic nuk e eliminon rrezikun. Më tutje, ai ka qenë i dënuar më parë në Zvicër, siç është paraqitur në hollësi në aktakuzë.

- Parashtrësat e avokatit mbrojtës duke kritikuar aktakuzën dhe duke paraqitur kundërshtime ndaj dyshimit të bazuar nuk janë të lejuara në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 432 paragrafit 2 të KPP-së. Faktet e lëndës janë duke u shqyrtuar në shqyrtimin gjyqësor i cili është në vazhdim e sipër.

Avokati mbrojtës nuk ka specifikuar se si është shkelur neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përveç pretendimit për shkelje të procedurës penale.

III. Gjyket e kolegjit



8. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës dhe përgjigja e paraqitur nga Prokurori i Shtetit janë të pranueshme dhe të paraqitura brenda afatit të përcaktuar.

9. Së pari, Gjykata Supreme vëren se ka shumë pak çështje në këtë kërkesë të cilat nuk janë paraqitur në ankesat e mëparshme dhe kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë. Kolegji pajtohet me Prokurorin se nuk është e saktë se përshkrimi faktik i të gjitha fakteve vendimtare të veprës penale duhet të përfshihen në dispozitiv të aktvendimeve të kundërshtuara, dhe të theksohet se cilat fakte konsiderohet të vërtetuara e cilat të pavërtetuara. Avokatit mbrojtës ia përkujtojmë se aktvendimi i Gjykatës Themelore ka të bëjë me vazhdimin e paraburgimit, dhe nuk është aktgjykim i cili do të lëshohet në fund të shqyrtimit gjyqësor. Dispozitivet e të dy aktvendimeve të kundërshtuara përmbajnë të gjitha detajet që kërkojnë sipas KPP-së. As Gjykata Supreme nuk mund të bëjë vlerësim të provave të cilat janë paraqitur deri më tani në shqyrtim gjyqësor, dhe që është çështje tjetër nga vërtetimi i dyshimit të bazuar. Dyshimi i bazuar është vërtetuar në disa raste të mëparshme, dhe Gjykata Supreme nuk mund të konstatojë ndryshe në këtë fazë të procedurës.

10. Në lidhje me rrezikun sipas nenit 187 të KPP-së, Gjykata Supreme vëren se i vetmi ndryshim i rrethanave është fakti se shqyrtimi gjyqësor ka filluar. Sidoqoftë, kolegji vëren se ende ka dëshmitarë të Prokurorisë të cilët akoma duhet të japin prova. Përndryshe, avokati mbrojtës nuk ka paraqitur asnjë argument që tregon se ka pasur shkelje të nenit 384 të KPP-së apo Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

11. Avokati mbrojtës pohon se atij nuk i është dhënë mundësia që të paraqes përgjigjen me shkrim ndaj propozimit të Prokurorit për vazhdimin e paraburgimit, dhe prandaj është bërë shkelje e nenit 191 paragrafit 2. Prokurori pohon se masa e paraburgimit nuk është vazhduar me propozim të Prokurorit, por sipas nenit 193 paragrafit 1, dhe prandaj nuk ka shkelje procedurale. Së pari, kolegji vëren se aktvendimi i kryetarit të trupit gjykues thekson se propozimi është paraqitur nga avokati mbrojtës për të bashkakuzuarin e të pandehurit (M. S.), duke kërkuar që masa e paraburgimit t'i zëvendësohet me një masë më të butë. Prokurorisë i është dhënë mundësia që të përgjigjet në këtë propozim. Nuk ka obligime që avokatit mbrojtës t'i jepet mundësia që të përgjigjen në përgjigje (posaçërisht si në këtë rast kur nuk ka të bëjë me të pandehurin të cilin avokati mbrojtës A. D. e përfaqëson). Aktvendimi i kryetarit të trupit gjykues në faqen 3 të versionit në gjuhën angleze thekson se ai,

'ka vendosur sipas detyrës zyrtare sipas nenit 193.2 të Kodit të Procedurës Penale ...'

Prandaj, është e qartë se kryetari i trupit gjykues ka vepruar sipas detyrës zyrtare, e jo si rezultat i propozimit të paraqitur nga Prokurori, dhe për këtë arsye nuk ka asnjë shkelje të KPP-së.

12. Prandaj, Gjykata Supreme nuk gjen asnjë shkelje substanciale të dispozitave të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale apo Konventave Ndërkombëtare, dhe refuzon kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.



Kryetare e kolegjit

Esma Erterzi

Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtëse

Kerry Kirsten Moyes

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit

Willem Brouwer

Gjyqtar i EULEX-it

Valdete Daka

Gjyqtare e Gjykatës Supreme



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik